



Krijo të ardhmen tënde!

**Institucioni Arsimor Privat
Gjimnazi Cambridge - Pejë**

**RREGULLORE
PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE**

Pejë, 2020

RREGULLORE PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE

1. Kushtet e përgjithshme

1.1. Në shkollën fillore dhe të mesme në Gjimnazin "Cambridge" mund të regjistrohen të gjithë fëmijët e moshës 4-6 vjeç në ciklin parafillor, 6–10 vjeçarë në ciklin fillor, 11–15 vjeçare në ciklin e mesëm të ulët dhe fëmijët 15-19 vjeç në ciklin e mesëm të lartë, pa asnjë diskriminim në bazë kombëtare, etnike, fetare, gjinore, racore, sociale, gjuhësore, rajonale, etj., me kusht që t'i plotësojnë kërkesat e veçanta për regjistrim, siç janë:

- Aftësitë minimale psiko-fizike për vijimin e shkollimit të rregullt.
- Moshë adekuate për regjistrim në vitin e parë, respektivisht kryerja me sukses e klasës paraprake sipas planit dhe programit mësimor të Kosovës ose një plani dhe programi mësimor të pranuar nga MASHT me aktin e licensimit, barasvlerës, apo me ndonjë akt tjetër juridik të aplikueshëm në Kosovë.
- Nënshkrimi i kontratës së shkollimit nga ana e prindit ose e kujdestarit të nxënësit dhe kryerja me rregull e obligimeve që dalin nga kjo kontratë.

1.2. Deri më 31 qershor të çdo viti kalendarik, shkolla shpallë vendet e lira për regjistrimin e nxënësve të rinj në vitin shkollor vijues. Shpallja bëhet në mjetet e informimit publik ose në mënyra të tjera të përshtatshme.

1.3. Regjistrimi i nxënësve të rinj për vitin shkollor vijues fillon më 1 korrik dhe vazhdon deri në fillim të vitit shkollor respektivisht deri në plotësimin e vendeve të lira.

1.4. Regjistrimi i nxënësve të rinj bëhet me përparësi sipas radhës së paraqitjes.

1.5. Regjistrimit të nxënësve në vitin e parë i paraprinë biseda me psikologun me qëllim të përcaktimit të shkallës së zhvillimit psiko-fizik të nxënësit.

1.6. Regjistrimi i nxënësve aktual të shkollës Gjimnazi "Cambridge" në vitin shkollor vijues bëhet deri më dt. 10 gusht. Pas kësaj date vendet e nxënësve të paregjistruar shpallen të lira.

1.7. Kontratat për shkollim për të gjithë nxënësit e regjistruar në vitin shkollor vijues duhet të nënshkruhen më së voni deri më 15 gusht. Mosrespektimi i këtij afati do të konsiderohet si heqje dorë nga regjistrimi.

Klasët:

Nxënësit mund të regjistrohen në kët o klasë:

- Parafillor
- Shkolla Fillore (I – V)
- Shkolla e Mesme e Ulët (VI-IX)



- Shkolla e Mesme e Lartë (X – XII)

Drejtimet:

Gjimnazi " Cambridge" ofron këto drejtime:

- Shkenca Natyrore (SHN)
- Matematikë – Informatikë
- Shkenca Shoqërore
- Mjekësi e përgjithshme

Dokumentet:

Cikli parafillor (mosha 4-6 vjeç)

Fëmijët duhet të kenë aftësi psiko-fizike dhe të rekomandohen nga pedagogu i shkollës për përshtatshmërinë për të vijuar me procesin mësimor;

- Kërkesa për regjistrim (formulari merret në web faqe ose në kopje fizike në shkollë)
- Certifikata e lindjes
- Certifikata e shëndetit
- Dy fotografi

Cikli fillor (klasa I-V)

- Kërkesa për regjistrim (formulari merret në web faqe ose në kopje fizike në shkollë)
- Certifikata e lindjes
- Dy fotografi
- Libreza nga klasa paraprake (vlen për nxënësit nga klasa e II-të)
- Vlerësimi nga pedagogu i shkollës

Cikli i mesëm i ulët (klasa VI-IX)

- Kërkesa për regjistrim (formulari merret në web faqe ose në kopje fizike në shkollë)
- Certifikata e lindjes
- Dy fotografi
- Libreza nga klasa paraprake
- Vlerësimi nga pedagogu i shkollës



Cikli i mesëm i lartë (X-XII)

Gjimnazi Cambridge - Pejë në nivelin e mesëm të lartë ofron këto drejtime:

SHKENCA NATYRORE
MATEMATIKË DHE INFORMATIKË
SHKENCA SHOQËRORE
MJEKËSI E PËRGJITHSHME

- Kërkesa për regjistrim (formulari merret në web faqe ose në kopje fizike në shkollë)
- Certifikata e lindjes
- Dy fotografi
- Dëftesa për përfundimin e Shkollimit të mesëm të ulët (dëftesa e vitit paraprak për klasët XI dhe XII)
- Vlerësimi nga pedagogu i shkollës

Shënim:

Nëse nxënësi regjistrohet në mes të gjysëmvetorit atëherë përveç dokumenteve të shënuara më lartë, duhet të sjellë edhe fletëkalimin nga shkolla paraprake.

Nëse nxënësi klasën paraprake e ka përfunduar jashtë Republikës së Kosovës, duhet të nostrifikojë dëftesën pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, sipas legjislacionit në fuqi.

Afatet:

Regjistrimi në Gjimnazin “Cambridge”, fillon nga muaji Maj deri në muajin Shtator.

Vërejtje:

Të gjitha dokumentet e nevojshme duhet të plotësohen para se të nënshkruhet kontrata për shkollim, ndërkohë që fletëparaqitjet mund të pranohen edhe pa dokumente të kompletuara.